



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 837, datë 28.10.2020

PËR

**PROCEDURAT, KRITERET E RREGULLAT PËR OFRIMIN
E SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret e rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit ndaj punëkërkuesve dhe punëdhënësve, që janë të regjistruar në zyrën përkatëse të punësimit në Republikën e Shqipërisë, për të përfituar nga këto shërbime.
2. Shërbimet e punësimit ofrohen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (në vijim, AKPA) nëpërmjet strukturave të varësisë.

II. PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT PËR PUNËKËRKUESIN

1. Struktura vendore përkatëse e punësimit, pas regjistrimit e dhënies së statusit të "Punëkërkuesit të papunë", sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuar në ligjin nr.146/2015, "Për punëkërkuesin", duhet të sigurojë informacion për punëkërkuesin lidhur me statusin social, përkatësinë sipas grupeve të veçanta, që përcakton legjislacioni në fuqi, si dhe të dhëna të

tjera plotësuese, nëse është e nevojshme, nëpërmjet ndërveprimit me baza të tjera të dhënash shtetërore ose portalit *e-Albania*.

2. Struktura vendore përkatëse e punësimit të AKPA-së, për të siguruar të dhënat për punëkërkuuesin, si dhe për hartimin e planit të trajtimit të tij, që ta bëjë të aftë për tregun e punës, ndjek këto hapa:
 - a) Interviston;
 - b) Profilizon (kërkon dokumente shtesë, nëse nevojiten);
 - c) Harton planin individual të punësimit.
3. Për të gjithë punëkërkuuesit, të cilët deklarojnë se janë të papunë dhe që kanë marrë statusin “Punëkërkuës” e “Punëkërkuës i papunë”, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr.146/2015, “Për punëkërkuuesin”, struktura vendore përkatëse e punësimit e AKPA-së bën profilizimin e punëkërkuuesit e nivelin e punësueshmërisë së tij, nëpërmjet intervistimit të tij, me qëllim mbështetjen me shërbime dhe programe, bazuar në nevojat e tyre. Nëpunësi i strukturës vendore të punësimit, në dakordësi me punëkërkuuesin e papunë, ndërton planin individual të punësimit, proces që përmbillet me nënshkrimin e një marrëveshjeje nga të dyja palët.
4. Punonjësi i shërbimeve të punësimit i strukturës vendore përkatëse të punësimit, gjatë vlerësimit e zbatimit të planit individual të punësimit të punëkërkuuesit të papunë, konstaton nëse personi, që po i nënshtrohet ciklit të trajtimit të shërbimeve të punësimit ka pengesa apo probleme të tjera që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me punësimin e tij, si më poshtë:
 - a) Probleme sociale dhe shëndetësore që mund të konstatohen gjatë trajtimit të tij e që pengojnë punësimin;
 - b) Janë duke përfituar programe nxitjeje punësimi të ofruara nga struktura vendore e punësimit;
 - c) Janë duke përfituar formim profesional të ofruar nga struktura vendore e punësimit.

Lidhur me problemet sociale dhe shëndetësore të konstatuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, struktura rajonale/vendore përkatëse e punësimit e referon menjëherë tek institucionet përkatëse të specializuara për trajtimin e problemeve dhe të pengesave të konstatuara.

5. Ofrimi i shërbimeve të punësimit për punëkërkuuesit e punëkërkuuesit e papunë dhe trajtimi i tyre paraqiten, si më poshtë vijon:

- a) Punëkërkuessit përfitojnë të gjitha llojet e shërbimeve të punësimit, por nuk referohen për të përfituar falas nga programet e tjera aktive të tregut të punës, që janë formimi profesional në qendrat publike të formimit profesional e pjesëmarrje në programet e nxitjes së punësimit. Këta punëkërkuess, kur nuk kërkojnë asistencën e strukturës vendore të punësimit, shërbimet i marrin nëpërmjet portalit *on-line* të AKPA-së. Në rastet kur i drejtohen për shërbime punësimi strukturës vendore të punësimit, pritja dhe trajtimi me shërbime ofrohen sipas procedurave të përcaktuara në “Manualin e ofrimit të shërbimeve të punësimit”;
 - b) Punëkërkuessit të papunë, pas vlerësimit të bërë në fazën e profilizimit nga strukturat vendore përkatëse të punësimit, ku përcaktohet niveli i punësueshmërisë, sipas të cilit hartohet plani individual i punësimit, që synojnë fuqizimin e individit e integrimin e tij në tregun e punës, i ofrohen të gjitha paketat e shërbimeve sipas radhës së dakordësuar nga ai dhe punonjësi i shërbimeve. Kjo metodologji rregullohet në manualin e shërbimeve të punësimit, që është dokument për përdorim të brendshëm të nëpunësve të strukturave të AKPA-së.
 - c) Profilizimi dhe kategorizimi sipas nivelit të punësueshmërisë të punëkërkuessve të papunë përcakton llojin e shërbimeve që do t’i ofrohen dhe referimin për pjesëmarrje në programet aktive dhe pasive të tregut të punës;
 - ç) Progresi i punëkërkuessit të papunë bëhet, si më poshtë vijon:
 - i. Në zbatim të planit individual të punësimit, struktura rajonale/vendore përkatëse e punësimit e AKPA-së ofron e ndjek në vazhdimësi paketat e shërbimeve, për të cilat janë dakordësuar të dyja palët. Progresi i bërë reflektohet në dosjen personale të punëkërkuessit të papunë, sipas fazave;
 - ii. Nëse gjatë zbatimit të planit individual të punësimit konstatohet progres jo i kënaqshëm, palët duhet të dakordësohen përsëri për rihartimin e këtij plani.
6. Shërbimet e punësimit në kategorinë e programeve aktive të tregut të punës ofrohen për të gjithë punëkërkuessit e papunë, sipas nevojave të tyre dhe sipas përcaktimeve në ligjin nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, dhe përfshijnë:
- a) shërbimet e informimit, ku informacioni mund të merret në mënyrë të drejtpërdrejtë në strukturat e AKPA-së ose nëpërmjet kanaleve alternative të komunikimit;
 - b) shërbimet e ndërmjetësimit për punësim të denjë, të cilat merren vetëm në strukturën rajonale/vendore përkatëse të punësimit të AKPA-së;

- shërbimet e mbështetjes për punësim, nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, jepen vetëm pranë strukturave rajonale/vendore përkatëse të punësimit të AKPA-së, pas vlerësimit e profilizimit të punëkërkuesve të papunë dhe trajtohen me akte ligjore të posaçme;
- c) shërbimet e këshillimit e të orientimit për karrierë, punësim dhe profesion, me qëllim për të rritur aftësitë e punësueshmërisë, që mund të ofrohen të individualizuara dhe/ose në grup. Shërbimet e formimit dhe aftësimin profesional, për të rritur punësueshmërinë e punëkërkuesve të papunë, jepen pranë zyrave të punësimit dhe qendrave të formimit profesional e bashkëpunimit të tyre (ky bashkëpunim rregullohet në “Manualin e ofrimit të shërbimeve të punësimit”);
- ç) Për grupe të veçanta me pengesa për t’u përfshirë në punësim ofrohen shërbime këshillimi më të thelluara, që mund të jenë të individualizuara dhe/ose në grup, nga zyra e punësimit ose institucione të tjera të specializuara. Kriteret e procedurat e detajuara për ofrimin e shërbimeve të këshillimit për çdo kategori të punëkërkuesve rregullohen në manualin e shërbimeve të punësimit dhe, në çdo rast, jepen duke u paraqitur pranë strukturave rajonale/vendore përkatëse të punësimit të AKPA-së.

7. Shërbimet e punësimit në kategorinë e programeve pasive të tregut të punës ofrohen për të gjithë punëkërkuesit, të cilët kanë marrë statusin “Punëkërkues i papunë”, sipas nevojave të tyre dhe sipas përcaktimeve në nenin 13, të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, dhe në ligjin nr.7703, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, që përfshin pagesën e të ardhurës nga papunësia. Kjo pagesë jepet vetëm pas regjistrimit e vlerësimit të punëkërkuesve të papunë pranë strukturave rajonale/vendore përkatëse të punësimit të AKPA-s. Plotësimi i dokumentacionit bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

III. PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT PËR PUNËDHËNËSIT

1. Çdo punëdhënës, që kërkon të përfitojë shërbime nga zyra përkatëse e punësimit, mund të regjistrohet në mënyrë elektronike apo duke u paraqitur vetë pranë strukturave rajonale/vendore përkatëse të punësimit të AKPA-së, duke plotësuar formularin përkatës, ku përfshihet edhe deklarimi për kontrollin e të dhënave.
2. Pas regjistrimit në sistemin e shërbimeve të punësimit, ndërmjet punëdhënësit dhe AKPA-së lidhet një marrëveshje bashkëpunimi, në të cilën listohen të gjitha shërbimet që do të marrë punëdhënësi, si dhe të

gjitha detyrimet e palëve. Punëdhënësit, të cilët interesohen vetëm për një shërbim specifik, i cili është detyrim ligjor, nuk do të jenë të detyruar për të nënshkruar marrëveshjen, por do të kenë mundësi të marrin shërbimin e kërkuar menjëherë.

3. Struktura rajonale/vendore e AKPA-së u mundëson punëdhënësve të regjistruar këto shërbime:

a) Informim lidhur me:

- i. kërkesat për punësim të tregut të punës;
- ii. programet e punësimit, arsimit e formimit profesional dhe mënyrat e aplikimit;
- iii. këshillimin për paraqitjen e vendit të lirë të punës;
- iv. këshillimin për ndërmjetësimin;
- v. legjislacionin e punës dhe të nxitjes së punësimit.

b) Regjistrim i punëdhënësit në sistemin informatik të shërbimeve të punësimit;

c) Publikim i vendeve të lira të punës, të ofruara nga punëdhënësit;

ç) Përditësim i të dhënave të tij në sistemin informatik të shërbimeve të punësimit;

d) Aplikim e përfshirje në programet e mbështetjes për ndërmjetësim e nxitje të punësimit sipas legjislacionit përkatës;

dh) Ndërmjetësim/rekrutim/ofrim kandidatësh potencialë dhe të përshtatshëm për vendet e lira të punës, të ofruara nga punëdhënësi;

e) Pajisje me dokumentacionin përkatës, në zbatim të legjislacionit në fuqi për të huajt, shtetasit e huaj, të punësuar pranë punëdhënësit;

ë) Informim/këshillim/mbështetje në proceset e marrëdhënieve të punës sipas legjislacionit përkatës;

f) Informim/këshillim/regjistrim për punëdhënësit, ofrues të vullnetarizmit, sipas legjislacionit përkatës;

g) Informim/deklarim/regjistrim për ofruesit e formimit profesional privat, sipas legjislacionit përkatës.

4. Në përfundim të procedurës, nëse punëdhënësi pranon të marrë shërbimet, sipas pikës 3, të këtij kreu, duhet të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi, e cila do të përfshijë edhe takimet e planifikuara ndërmjet palëve, si dhe progresin e bërë gjatë bashkëpunimit.

5. Çdo punëdhënës, i cili ka një marrëveshje bashkëpunimi pranë strukturave rajonale/vendore përkatëse të punësimit të AKPA-së, si klient që kontribuon në realizimin e punësimit të denjë, ka të drejtë:
 - a) të publikojë në strukturat rajonale/vendore përkatëse të punësimit të AKPA-së vendet e lira të punës, nëpërmjet sistemit të informacionit të strukturave rajonale/vendore, për të përfituar nga shërbimet e ndërmjetësimit e të përputhjes me vendin e punës që ato ofrojnë;
 - b) të aplikojë në strukturën e AKPA-së rajonale/vendore për të përfituar nga programet e nxitjes së punësimit e të kualifikimeve që ofron institucioni përgjegjës për punësimin e aftësitë;
 - c) të aplikojë në strukturat e AKPA-së për të përfituar nga Fondi Social i Punësimit, sipas përcaktimeve në vendimin nr.177, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, kriteret dhe detyrat e bordit të administrimit të Fondit Social të Punësimit dhe mënyrat e përdorimit të tij”.

IV. PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT PËR TË TJERË

1. Strukturat e punësimit të AKPA-së mund të japin shërbime informimi për të dhëna statistikore apo informacione të tjera për tregun e punës për qëllime studimore etj. ndaj çdo entiteti tjetër të interesuar që nuk është i regjistruar pranë tyre, si: organizata, shoqata të ndryshme, agjenci private punësimi apo palë të treta të tjera.
2. Përfituesit, sipas pikës 1, të këtij kreu, i ofrohen shërbime kundrejt tarifave, që vendosen sipas legjislacionit të fuqi nga ministria përgjegjëse për financat.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, miraton manualin e shërbimeve të punësimit, të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/Agjencisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

ANILA DENAJ



NR.PROT. 3300/1
DATË 29.10. 2020

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

